



KOMUNA LIPJAN

KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS:

E përpiluar më 25.07.2019

Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga drejtori i Drejtoria e Prokurimit z. Adem Duriqi në vazhdim (përmendet) Autoriteti kontraktues dhe

NNP "Wenda" nga Vushtrria të cilin e përfaqëson Kadri Selmani, në vazhdim do të përdoret ("Kontraktuesi") në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Titulli i kontratës: Ndertimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe kyqjet e rrjeteve të kanalizimit-Projekt 2 vjeçar

" me numër referues: 613 019 072 521

Neni 1 Lënda

1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit: Ndertimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe kyqjet e rrjeteve të kanalizimit-Projekt 2 vjeçar L=3678.65m' të gjitha të parapara të pershkrimit i çmimeve.

1.2 Punët do të ekzekutohen brenda planit dinamik gjatë viteve fiskale 2019-2020, por plani dinamik për përfundimin e të gjitha punëve nuk mund të jetë me shumë se 120 dite pune gjatë viteve fiskale 2019/2020 por jo më vonë se 31.10.2020.

Përshkrimi i punëve është në projektin kryesor dhe do të punohet sipas paramasave dhe parallogarisë të specifikuar në dosje të tenderit me nr. Ref. 613 019 072 521 dhe projektit detaj i cili gjeqdet në DPU

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi përgjithshëm i punëve shprehur në shifra është 168,479.41€ dhe çmimin e punëve me fjalë: njëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë /euro/ e katërdhjetë e një /centë/

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbal i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim, i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në 4 origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues, një origjinale për Kontraktuesin dhe një për buxhet.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Kadri Selmani
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.07.2019	Data:	25.07.2019
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Punë"** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **"Kontraktuesi"** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **"Menaxheri i Projektit"** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **"Çmimi Kontratës"** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **"Vendi i ndërtimit"** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **"Pajisjet e kontraktuesit"** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **"Skicat"** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transfërimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

5.2 Nëse menaxheri i projektit i kërkon Kontraktuesit të heq një person i cili është anëtar i stafit të Kontraktuesit ose fuqi punëtore, duke deklaruar arsyet, Kontraktuesi duhet të siguroj që personi ta lë vendin e punimit brenda 72 orëve dhe nuk ka lidhje të mëtejshme me punën në kontratë.

Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj që ai/ajo do të kryej të drejtat dhe detyrat e tij në mënyrën të tillë që të përmbushen përgjegjësitë që janë në pajtim me kushtet e caktuara në kontratë.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rëndë dakord në programin e bërë sipas Neni 8.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.8 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.9 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastiit, objektet përreth, trafikun etj.

6.10 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim personal ose vdekje.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërbllimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim, në të cilin do të paraqesë mënyrën e rregullt të kryerjes së punëve dhe metodat e përgjithshme që do ti zbatojë, renditjen e aktiviteteve të punëve në baza prioriteti, dhe do të llogarisë kohën për secilin aktivitet të specifikuar gjër në përfundimin e punëve të kontraktuara.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim për çdo hollësi Autoritetit Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do ti sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuar, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Neni 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuere të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuere të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuere e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

Neni 14 Paramasa dhe Parallogaria

14.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhën nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

Neni 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do të paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

Neni 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 23 Kostoja e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimit të punëve

24.1 Pasi që kryesisht të jenë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryej të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve te pranimit te kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do te lëshoj Certifikatën e pranimit te punëve, duke cekur datën, sipas mendimit te tij, e përfundimit te punëve ose do te jap instruksione për punët te cilat duhet te kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit te kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit te Projektit, ka te drejtën e pranimit te kësaj Certifikate brenda 21 ditëve te kompletimit te punëve dhe te përmirësimit te defekteve te cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

Neni 25 Llogaritja përfundimtare

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit te Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët te cilat duhen ti paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do te lëshoj Certifikatën e periudhës garantuese te defekteve dhe do te certifikoj cilëndo pagese finale e cila duhet ti paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit te llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren te meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do te vendos mbi shumën e cila do ti paguhet Kontraktuesit dhe do te lëshoj certifikatën mbi pagesën.

Neni 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 27 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 30 Forca madhore

30.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejt që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) ose vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet Përgjithshme Kontratës	e të	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni . Nr.	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jete shqipe
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për punët brenda 3 dite nga data e nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxher i Projektit është Labinot Dedushi tel: 044 315 603
Fillimi punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë: 3 dite nga data e nënshkrimit të kontratës prej 28.07.2019 dhe do të zgjatë 120 dite pune gjatë viteve fiskale 2019-2020, por jo më vonë se deri më 31.10.2020 Plani dinamik përfshin kontratë dyvjeçare fiskale (2019-2020). Çdo vonesë pa arsye më gjatë se plani dinamik i kontraktuar (31.10.2020) do të konsiderohet shkelje e kontratës dhe do të zbatohen penalet.
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) në afat 1 vjeçar pas pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do ti sanojë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim
Shkaqet për	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 dite pas aprovimit të Programit për

kompensim		Punët
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha punët janë: për të gjitha të metat që paraqiten te kontraktuesi me fajin e tij do të paguaj nga 0.25% në ditë. Nëse vonohet në përmbushjen e kryerjes së punëve sipas planit dinamik gjithashtu do të zbatohet kjo përqindje. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Parapagimi	20.1	Nuk ka parapagim
Pagesa	20.2	Pagesat do të bëhen: sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Pagesat për vitin 2019 do të kryhen deri në vlerën prej 155.000.00€, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 13,479.41 do të kryhen në vitin 2020 duke përfshirë edhe 10% të mbajtur nga secila faturë e cili do të paguhet pas lëshimit të Çertifikatës për përdorim dhe dorëzimit të garancionit për punët e kryera në afat prej 12 muajve
Rishikimi i çmimeve		Rishikimi i çmimeve - nuk pranohen ndryshime të çmimit, dhe do të paguhet vetëm shuma e cekur në nenin 2 pjesa e parë, në rast se paraqiten pengesa të cilat duhet eliminuar patjetër për realizimin e projektit, do të rregullohet me aneks kontratë
Mbajtja Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% nga vlera e kontratës do mbahen deri sa nuk kryhet pranimi teknik për punët e kryera sipas kësaj kontrate.
Siguria e ekzekutimit.	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në shumën prej 16,847.94€ e cila paguhet me rastin e nënshkrimit të kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj; nëse nuk ka vërejtje gjat kësaj kohe në punët e kryera, kontraktuesit do t'i kthehet siguri i ekzekutimit, në të kundërtën nëse kontraktuesi dështon në përfundimin e punëve apo nëse paraqiten vërejtje gjat kohës së sigurimit, siguri i ekzekutimit do të konfiskohet apo nëse ka mundësi të eliminimit të të metave këto mjete do të përdoren për këtë qëllim
Shkëputja e kontratës	23	Kontrata mund të shkëputet me vullnetin e njërës palë kontraktuese për shkak të shkeljeve materiale të kontratës, në rastet si në vijim: Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit të punëdhënësit; Menaxheri i projektit urdhëron pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; Pala tjetër kontraktuese falimenton apo hyn në likuidim, përveç me përjashtim të rastit të riorganizimit apo shkrirjes; Menaxheri i projektit në njoftimin me shkrim që i bënë punëmarrësit mbi evitimin e defekteve, e njofton edhe mbi atë se mos evitimi i defekteve paraqet shkelje bazë të kontratës, megjithatë punëmarrësi nuk ndërmerr masat e nevojshme paraprake për evitimin e defekteve, kështu që dështon në korrigjimin e defekteve brenda 30 ditë pune që përcaktohet nga menaxheri

		projektit të Punëdhënësit; Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e defekteve mund të paguhet; Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje materiale të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me klauzolën 10.1, Menaxheri Projektues do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës. Kur punëdhënësi i paraqet shkresë përkatësisht vendim mbi shkëputjen e kontratës, me këtë kontraktuesi obligohet që brenda 15 ditë pune duke llogaritur nga data e marrjes së vendimit mbi shkëputjen e kontratës, ta pastrojë vend ndërtimin nga mbeturinat eventuale që janë paraqitur gjatë kryerjes së punës, ta sigurojë vend ndërtimin dhe të largohet.
20. Pagesa pas shkëputjes së kontratës	24	Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera Penalitetet për te metat nuk futen në vlerësim; Nëse shuma totale e borxhit të punëdhënësit tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj punëdhënësit. Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale bazë të kontratës, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë punët e përfunduara gjer në momentin e ndërprerjes së kontratës, materialet e porositura, pagesën e punëtorëve për kryerjen e punëve të kontraktuara, koston e sigurimit të vend ndërtimit me minus pagesat në avans të marra para datës së marrjes së vendimit mbi shkëputjen e kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Palët Kontraktuese pajtohen që kontestet eventuale që lindin me rastin e dispozitave të kësaj kontrate të zgjedhin me marrëveshje. Afati për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët kontraktuese pajtohen që të jetë 15 ditë nga dita e paraqitjes së kontestit nga ana e palës do t'i dorëzohen për arbitrim <specifiko organin për zgjidhje të mosmarrëveshjeve> në inicuese
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykatën Supreme e Kosovës</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA
Ndërtimi i shtratit të Lumit në Janjevë dhe kyqjet e rrjeteve të
kanalizimit

Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	njësia	sasia	çmimi për njësi-€	totali me TVSH €
1	PUNET PARAPRAKE				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjës për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punës si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punës.	m'	3,678.65	0.15	551.80
1.2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detaj operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit (rrjeti elektrik, rrjeti i telefonisë shtëpiake, etj)	m'	3,678.65	0.90	3,310.79
1.3	Pastrimi i trases së lumit nga drunjet dhe gjesendet tjera që e pengojnë rrjedhën e lumit. Në pastrim të hyjnë të gjithë trupat e drunjeve, shkurreve dhe mbeturinave. Në çmim të kalkulohet komplet pastrimi i lumit për meter gjatësi.	m'	3,678.65	0.70	2,575.06
1.4	Formsimi dhe ngjeshja e skarpates dhe fundit të trases së lumit për gjatësi komplet gjatësisë së lumit. Në çmim të kalkulohet komplet formsimi dhe ngjeshja e sipërfaqeve të lumit për m².	m²	29,883.73	0.50	14,941.87
Subtotali:					21,379.50

2	PUNËT E DHEUT				
2.1	Germimi dhe grryerja e materialeve te lumit dhe te mbeturinave në lumë si dhe heqja e shtresës jo mbajtëse në përbërje të humusit si dhe bartja e tyre deri në deponine deri ne 15 km.	m³	15,915.68	1.20	19,098.82
2.2	Mbushja me dhe për krijimin e argjinaturave të lumit si dhe për mbushjen nga terreni ekzistues deri te muri mbrojtës i shtratit të rregulluar. Mbushja duhet të bëhet me dheun e sjellur nga deponia me material të përshtatshëm për këtë qëllim. Sjellja e dheut nga deponia të cilën e cakton organi mbikëqyrës. Në çmim duhet të llogaritet: gropimi në deponi, tansporti deri në trasë, shpërndarja, ngjeshja e dheut në shtresa 30cm deri në trusninë natyrale (nëse duhet edhe të laget me ujë), dhe planifiimi i saj.	m³	3,836.93	0.60	2,302.16
2.3	Devijimi i shtratit të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathte, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencen e ujit.	m'	750.00	5.00	3,750.00
2.4	Përdorimi i pompave për largim të ujrave gjatë kryerjes së punëve ndertimore (sipas nevojës).	m'	375.00	4.50	1,687.50
2.5	Nivelizimi, i siperfaqeve te brigjeve dhe ngjeshja me formesim ne formen e shkalleve per vendosjen e bllokut te pjerrinave.	m²	5,227.78	0.25	1,306.95
					Subtotali: 28,145.42
3	PUNËT NDERTIMORE LUMI I RREGULLUAR				
3.1	Furnizimi transporti si dhe vendosja e zhavorit (0-62) per mbushjen dhe stabilizimin e pjeseve te lumit ku behet ndertimi i mureve.	m³	575.36	7.00	4,027.52
3.2	Furnizimi transporti, ngjeshja dhe stabilizimi i zhavorit, (0-32)mm, sipas profilave, përgjate shtratit të lumit, siq është e cekur në projekt.	m³	283.50	7.00	1,984.50

3.3	Furnizimi transporti si dhe vendosja e betonit hidroteknik C-30/37. Betoni sherben ne themelet e murim te gurit.	m ³	425.04	60.00	25,502.40
3.4	Blerja, transporti, këputja, lakimi dhe montimi i hekurit (armaturës sipas detaleve ne projekt) Armatura S-500.	kg	11,086.00	0.68	7,538.48
3.5	Furnizimi transporti I Gurëve (10-30)cm dhe mbushja me llaç Çimento me radhitja dhe foresimi ne sipërfaqe te rrafshet ne pjesen e sipërme. Ne qmim te kalkulohet komplet puna dhe materiali per m ³ te sipërfaqes se punuar t=30cm.	m ³	639.56	7.00	4,476.92
3.6	Furnizimi transporti I Gurëve (10-50)cm dhe mbushja me llaç Çimento me radhitja dhe foresimi ne pjesen e murit te drejt vertikalisht. Ne qmim te kalkulohet komplet puna dhe materiali per m ³ te sipërfaqes'se punuar te gurit.	m ³	1,074.29	7.00	7,520.03
3.7	Blerja dhe vendosja e rrasave të guri në shtratin e lumit te mureve ekzistuese. Rrasat duhen të jenë me karakteristika si të rrasave të Gllaravës. Mveshja me llaq te qimentos dhe mbushja e fugave bëhet me rrasa me forma të ndyshme dhe trashësi d=3.0 cm .	m ²	1,055.46	5.00	5,277.30
3.8	Furnizimi me beton I 8 urave me gjeresi 4m' ne shtrat të lumit nga betoni C30/37 . Në çmim të llogaritet komplet sasija e betonit te urave.	m ³	207.80	60.00	12,468.00
3.9	Furnizimi transporti si dhe vendosja e gardhit metalik I ngjyrosur ne dy shtresa, anash ures. Gypate gardhit me diameter fi-63 ne dy renda horizontale dhe qdo 1.5m, vertikale, te ankeruara ne betonin e urave. Qmimi komplet per gjatesi te gardhit.	m'	112.00	16.00	1,792.00
3.10	Blerja, transporti, këputja, lakimi dhe montimi i hekurit. Te specifikuar ne Projekt te urave.	kg	19,575.35	0.68	13,311.24
		Subtotali:			83,898.39

4	KANALIZIMI FEKAL EKZISTUES				
4.1	Gërmimi i kanalit për kolektorët kat. III-IV me makinë dhe me dorë me gjërësi sipas normave dhe standardeve .Ne qmim te kalkulohet edhe mbulimi i kanalit me dheun e germuar.	m ³	1,368.00	1.20	1,641.60
4.2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1 cm.	m ²	460.00	0.30	138.00
4.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja betonit hidroteknik C-25/30, për mbulimin e gypit në kalim të lumit. Ne qmim te betonint te kalkulohet edhe rrjeta metalike Q335 15m ² .	m ³	78.00	60.00	4,680.00
4.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 Ø160	m'	520.00	2.90	1,508.00
4.5	Furnizimi transporti si dhe montimi i gypave dhe kthesave nga materiali PVC Ø160. Materiali që përdoret në këtë kyqje Gypi 1m' PVC-Ø160, 4xQ-45 PVCØ160, Revizuesi PVCØ160, betonimi me ankerë në mur dhe materiali llaç çimento ose (mas bituminoze) në kyqje të gypit ekzistues dhe gypit PE SN8 Ø160 . Ne qmim te kalkulohet komplet kyqja dhe të përshtatet me gjendjen ekzistuese për copë.	copë	12.00	70.00	840.00
4.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonarme për pllakën e poshtme të pusëve me betonarme C- 20/25 dhe armatura rrjet Ø8.5 10/10cm trashësia d=20cm. Te kalkulohet komplet bazamenti i pusëve për kubit të betonit.	m ³	36.00	60.00	2,160.00
4.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta me përpunim sipas detalit.	m ³	25.00	60.00	1,500.00
4.8	Furnizimi transporti dhe montimi i pusëve prej betonit të armuar 3xØ1000/1000mm 1xØ1000/700mm (elemente të parafabrikuara).Ne qmim te kalkulohet komplet pusëta me lartësi 3.7m' dhe kapaku nga betonarmeja.Qmimi komplet pusëve për copë.	copë	80.00	75.00	6,000.00
4.9	Furnizimi transporti si dhe lyerja me llaç izolues e takimit të dy pusëve. Te kalkulohet komplet izolimi i të gjitha pusëve në këtë projekt.	copë	240.00	6.00	1,440.00

4.10	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø16 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	copë	720.00	2.00	1,440.00
		Subtotali:			21,347.60
5	KANALIZIMI FEKAL				
5.1	Gërmimi i kanalit për kolektorët kat. III-IV me makinë dhe me dor më gjërësi sipas normave dhe standardeve .Ne qmim te kalkulohet edhe mbulimi i kanalit me dheun e germuar.	m³	1,012.50	1.20	1,215.00
5.2	Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit .	m²	1,650.00	0.30	495.00
5.3	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m²	562.50	0.25	140.63
5.4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorrit në fundin e kanalit, anash dhe mbi tub me ngjeshje .	m³	253.13	7.00	1,771.88
5.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 Ø250	m'	750.00	6.00	4,500.00
5.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonarmes për pllakën e poshtme të pusetave me betonarme C- 20/25 dhe armatura rrjet Ø8.5 10/10cm trashesija d=20cm. Te kalkulohet komplet bazamenti i puseta për kubit te betonit.	m³	19.00	60.00	1,140.00
5.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim,sipas detalit.	m³	12.00	65.00	780.00
5.8	Furnizimi transporti dhe montimi i pusetave prej betonit të armuar Ø1000/1000mm Ø1000/700mm (elemente të parafabrikuara).Ne qmim te kalkulohet Komplet puseta me lartësi 1.8m' dhe kapaku nga betonarmeja.Qmimi komplet pusetave per copë.	copë	39.00	70.00	2,730.00
5.9	Furnizimi transporti si dhe lyerja me llaq izolues e takimit te dy pusetave. Te kalkulohet komplet izolimi i te gjitha pusetave ne ket projekt.	copë	78.00	6.00	468.00

5.10	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø16 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	copë	234.00	2.00	468.00
		Subtotali:			13,708.50
Rekapitullimi					
1	PUNET PARAPRAKE				21,379.50
2	PUNËT E DHEUT				28,145.42
3	PUNËT NDERTIMORE LUMI I RREGULLUAR				83,898.39
4	KANALIZIMI FEKAL EKZISTUES				21,347.60
5	KANALIZIMI FEKAL				13,708.50
	Totali me TVSH:				168,479.41